



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 781 Prot.

Tiranë, më datë 21.06 2022

VENDIM

Nr. 281, datë 21.06.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.06.2022:

VENDOSI:

1. Shtyrje e Vendimmarrjes për projektin “Bonus rijetësimi Qendra interaktive”, Gjirokastrë, Monument Kulture Kategori II, me aplikues dhe zhvillues Eni Kaci;
 - Ndërhyrjet të jenë në përputhje me materialet tradicionale të zonës, duke harmonizuar nga pikëmapja arkitektonike të dyja modulet e ndërtesës.
2. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

KRYETAR
Elva MARGARITI

